



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Nr. Prot. 744 Dt. 25.03.2022

PËR:	- Këshillat e Fakulteteve të UIBM - Dekanët e Fakulteteve
PËRMES:	
CC:	
NGA:	- Prof. dr. Alush Musaj, rektor
TEMA:	- Adresimi i çështjeve të konstatuara nga Senati në procesin e konkursit, të datës 1.10.2021, për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik

Të nderuar,

Në mbledhjen e Senatit, mbajtur më 18.03.2022, si dhe në mbledhjet paraprake të Senatit, është diskutuar lidhur me disa nga rastet e konstatuara nga Senati kur anëtarët e komisioneve vlerësuese kanë hartuar raporte jo profesionale dhe kanë rekomanduar dhe propozuar për zgjedhje në thirrje kandidatë që në kuadër të konkurrencës nuk kanë qenë më meritorët për t'u zgjedhur në cilësinë e personelit akademik.

Në konkursin e datës 01.10.2021, për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, janë hasur raporte që nuk kanë marrë miratimin e Senatit. Në disa nga rastet, është konstatuar se kandidatët e propozuar nga komisionet recensuese, e në raste të caktuara dhe nga këshillat e fakulteteve, nuk i kanë plotësuar kushtet e parapara me konkurs, Statutin e Universitetit dhe Rregulloren për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancim të personelit akademik nr. prot. 1667 dt. 28.09.2021. Rastet kanë qenë mjaft të qarta, duke mos plotësuar kushtet e parapara, sikurse janë:

1. të ketë të publikuar monografi (ashtu siç kërkohet me Statut dhe Rregullore);
2. kandidatët për avancim në thirrjen prof. dr. dhe prof. asoc. dr. të kenë një numër të punimeve të publikura, ashtu siç kërkohet me Rregullore dhe Statut, të publikuara pas marrjes së titullit prof. ass;
3. keqinterpretim i nenit 11 të Rregullores për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancim të personelit akademik Nr. 1667 dt. 28.09.2021. Lidhur me rastin konkret, komisioni recensues me rastin e vlerësimit të kandidatëve, duke i dhënë përparësi



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË

kryesore intervistës me gojë, ka bërë zhvlerësimin e të gjitha kushteve thelbësore që një kandidat duhet t'i plotësojë për t'u zgjedhur në thirrjen asistent (neni 8 i rregullores, paragrafi 1 dhe 2. Në intervistën me gojë vlerësohet përshtatshmëria e kandidatit lidhur me aftësinë pedagogjike dhe atë të mësimdhënies, (neni 11, paragrafi 2 i rregullores). Andaj, intervista duhet kuptuar si njëri nga kriteret dhe kurrsesi si kriter thelbësor që i dominon kushtet e parapara me nenin 8 të Rregullores, paragrafi 1 dhe 2. Këtë fakt e ka konstatuar Komisioni Qendror i Studimeve, i cili i ka propozuar Senatit që propozimi i fakultetit përkatës të kthehet për rishqyrtim në Këshillin e Fakultetit, si dhe Komisioni i ankesave i Senatit gjatë shqyrtimit të ankesave të kandidatëve.

4. rekomandimi i komisionit recensues ka qenë jo i plotë dhe jo profesional, në rastin kur komisioni propozimin e dhënë për avancim në thirrje e bazon duke konstatuar në Raport: "Nëse zyra ligjore e konfirmon interpretimin e nenit 5, që dispensat me ligjëratat e autorizuara (shih Tabela V.1), mund të ekuivalentohen me një tekst universitar, atëherë ne do të pajtohemi me atë interpretim dhe do të konsiderojmë se kandidati e përmbushë edhe këtë kriter". Duke konstatuar këtë në raportin vlerësues, komisioni është treguar shumë jo profesional, duke e bartur përgjegjësinë e tij të rekomandimit tek një zyrë administrative dhe duke hequr dorë nga rekomandimi përfundimtar.

Trajtimi i këtyre çështjeve nga organet e fakulteteve dhe të rektoratit, në asnjë moment nuk e cënon autonominë e organeve të Universitetit dhe të personelit akademik dhe administrativ, por tregon përkushtim për një punë më profesionale duke respektuar me përpikëri Statutin dhe aktet e brendshme të UIBM.

Të gjitha çështjet e ngritur më lartë trajtohen si jo profesionale dhe në kundërshtim me Statutin dhe aktet e brendshme të UIBM:

- Neni 10, paragrafi 1 i Statutit "Personeli akademik e administrativ i Universitetit dhe studentët duhet të sillen në pajtueshmëri me legjislacionin e aplikueshëm, me përkushtim dhe në përputhje me standardet dhe vlerat më të larta etike dhe profesionale".



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

- Neni 178, paragrafi 1, nënpika 1.5 dhe 1.6. “1. Personeli akademik i Universitetit është i obliguar të respektojë: 1.5. parimet e ndershmërisë profesionale dhe shkencore; 1.6. kodin etik;”
- Neni 11, paragrafi 5; neni 12, paragrafi 7 dhe neni 16, paragrafi 18, 20, 21 dhe 26 të Rregullores për zgjedhje, rizgjedhje dhe avancim të personelit akademik Nr. 1667 dt. 28.09.2021, të cilat kanë të bëjnë me përgjegjësitë e komisioneve vlerësuese.

Gjithashtu, në procedurë të realizimit të konkursit janë shprehur mjaft shumë edhe vonesat e organeve dhe të zyrtarëve në zhvillimin e procedurave brenda afateve të përcaktuara me Rregulloren. Rastet janë identifikuar me tejkalim dhe mosrespektim të afateve nga komisionet recensuese, Këshillat e Fakulteteve dhe të Senatit të Universitetit, duke përfshirë këtu edhe zyrtarët përgjegjës për (sinjalizim) të respektimit të afateve të brendshme të përcaktuara me rregullore. Si pasojë e mosrespektimit të këtyre afateve ka dështuar realizimi i konkursit për personel akademik për 12 pozita pune, në atë mënyrë që Senati ka anuluar konkursin për 12 pozita. Anulimi i konkursit është bërë me arsyetim të mosrespektimit të afateve të brendshme dhe me qëllim të evitimit të shkeljeve administrative në procedurën e rekrutimit të këtyre pozitave. Ndoshta në këtë situatë të krijuar duhet pasur parasysh që konkursi aktual ka qenë konkursi i parë që është realizuar me rregulloren e re dhe që ka përcaktuar afatet strikte të brendshme. Rregullorja e re ka krijuar situatë të re dhe të gjithë ne, tani e tutje, duhet të jemi të përkushtuar që të respektojmë këto afate. Marrë parasysh këtë, Senati në mbledhjen e datës 18.03.2022, ka nxjerrë vendim për rishpalljen e konkursit për të gjitha pozitat të cilat janë anuluar për shkak të shkeljeve të afateve të përcaktuara me rregullore.

Kërkojmë nga Këshillat e Fakulteteve dhe dekanët që në harmoni me rregulloret e brendshme të bëjnë trajtimin e të gjithë këtyre çështjeve të ngritura dhe nëse është e nevojshme edhe të ndërmarin masa për rastet e caktuar, si dhe të sigurojnë që lëshimet e tilla në të ardhmen mos të përsëriten.

Universiteti është i përkushtuar që të respektojë në përpikëri dispozitat ligjore dhe statutare si dhe aktet e brendshme të UIBM.

Me respekt,